



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA – BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.765 prot., i AK, datë 30.12.2022, “Njoftim i përqendrimit ndërmjet OTP BANK NYRT./ JOINT STOCK COMMERCIAL MORTGAGE BANK “IPOTEKA BANK”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të shoqërisë Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK” nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje aksionesh”, palët janë:

**Pala blerëse: OTP Bank Nyrt** (OTP Bank Plc.) është një shoqëri aksionare publike, me objekt aktiviteti: Financim huaje; ndërmjetësime të tjera monetare; veprimtari të shërbimit financiar; veprimtari të agjentëve të sigurimit dhe ndërmjetësimit; veprimtari të menaxhimit të fondeve; aktivitete të kontabilitetit, llogari mbajtjes dhe auditimit, konsulencë tatimore etj.

Grupi OTP, i kryesuar nga OTP Bank Nyrt, është një nga ofruesit e shërbimeve bankare në Evropën Qendrore dhe Lindore (CEE).

OTP Bank Nyrt është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të saj OTP Bank Albania SHA.

**Pala shitëse:** Ministria e Financës e Republikës së Uzbekistanit.

**Shoqëria Target: Joint - Stock Commercial Mortgage Bank “IPOTEKA - BANK”** (“IPOTEKA - BANK”) është një shoqëri tregtare, e zotëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Uzbekistanit, me objekt aktiviteti ofrimi i shërbimeve bankare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**